



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2667/ 5 prot.

Datë 10.09.2026

V E N D I M
Nr. 1136/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Ervin Simo	Anëtar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.09.2026, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 2667/2026 prot., datë 27.08.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-93228-07-13-2026, me objekt “Ndërtimi i Kolektorit Kryesor të Kanalizimeve dhe Impiantit të Trajtimit të Ujrave Të Ndotura Maliq”, me fond limit 123,593,424.32 (njqind e njezet e tre milion e pesqind e nentedhjetë e tre mijë e katerqind e njezet e kater pike tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “T & XH” SHPK me NIPT L72121504I, me Adresë: Godina “Qendra e Biznesit Pajtoni”, Kati 3-të, Rruga Dytësore Tiranë - Durrës, km1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Shoqeria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.
Adresa: Rruga: “Boris Plumbi”, Rajoni Nr.1, Nr. 20, Korçë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 14.07.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-93228-07-13-2026, me objekt “Ndërtimi i Kolektorit Kryesor të Kanalizimeve dhe Impiantit të Trajtimit të Ujrave Të Ndotura Maliq”, me fond limit 123,593,424.32 (njqind e njezet e tre milion e pesqind e nentedhjete e tre mije e katerqind e njezet e kater pike tridhjete e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

II.2. Në datën 29.07.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datë 12.08.2026, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve (SPE) mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave, si më poshtë vijon:

1. BOE “Ndregjoni” SHPK & “Ndërtimi” SHPK	79,549,916 lekë	skualifikuar
2. “T & XH” SHPK	95,528,202 lekë	skualifikuar
3. BOE “Ed Konstruksion” SHPK & “Inerti” SHPK	115,485,405 lekë	kualifikuar
4. “Meteo” SHPK	119,532,315 lekë	kualifikuar

II.4. Në datë 12.09.2026 operatori ekonomik “T & XH” SHPK është njoftuar për klasifikimin dhe skualifikimin e tij nga procedura prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se:

Operatori Ekonomik “T & XH” shpk skualifikohet nga procedura e prokurimit të sipërcituar për shkak se nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën për “Modifikimin e Dokumentave të Procedurës së Prokurimit” me Objekt “Ndërtimi i Kolektorit Kryesor të Kanalizimeve dhe Impiantit të Trajtimit të Ujrave të Ndotura Maliq”, ku përcaktohet se: Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të vlefshme të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- NP-1 A Punime gjurmimi në tokë
- NP-4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP-7 D Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje;
- NP-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore Për punimet speciale të ndërtimit:
- NS-18 B Punime topogjeodezike

Konkretisht nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara nga operatori ekonomik T&XH shpk në Sistemin e prokurimeve Elektronike nuk rezulton të jetë paraqitur Licencë e kategorisë NP-7D Ujësjellësa, gazesjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje në plotësim të kriterit sa më sipër. Nga ana e operatorit ekonomik rezulton të jetë dorëzuar Licenca me Nr.NZ 7784/17 nga ku rezulton se ofertuesi është i licensuar për kategorinë e licensës NP-7A Ujësjellësa, gazesjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje, pra në një nivel më të ulët se ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit. Gjithashtu KVO vëren se ofertuesi ka paraqitur një deklaratë angazhimi për mbështetje në kapacitete me

kompaninë I.D.K-Konstruksion ku parashikohet se: “Shoqëria “I.D.K – KONSTRUKSION” sh.p.k. deklaron dhe angazhohet se do të vërë në dispozicion të Shoqërisë “T&XH” sh.p.k., për qëllime të kësaj procedure prokurimi dhe gjatë gjithë periudhës së nevojshme për zbatimin e kontratës, kapacitetin e saj të licencimit në kategorinë NP-7, së bashku me punonjësit dhe mjetet e kërkuara për zbatimin e kontratës me objekt: “Ndërtimi i Kolektorit Kryesor të Kanalizimeve dhe Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Maliq”, si më poshtë:

z. Arjan Ramcaj – Teknik Hidroteknik
z. Ergys Kolgjini – Karpentier
z. Dritan Topi – Karpentier
z. Shaban Klari – Betonues
z. Avenir Islamaj – Betonues
z. Agim Karanxha – Betonues
z. Bujar Hysa – Hekurthyes
z. Erion Thomaj – Hekurthyes
z. Haxhi Hoxhaj – Hidroizolues
z. Eris Ndoni – Hidraulik
z. Nikolin Paluca – Hidraulik
z. Dritan Aliu – Saldator
z. Ismet Murati – Konstruksione metalike
z. Albert Kerxhalliu – Shofer
z. Oldis Hebibasi – Buldozerist
z. Krenar Qinami – Automakinist
z. Maksim Gjata – Automakinist

Mjete:

- Kamionçinë me kapacitet mbajtës nga 1.5 deri në 2 ton
- 1 minifadromë

Sa më sipër KVO vlerëson se mbështetja në kapacitete e ofertuesit tek shoqëria I.D.K – KONSTRUKSION” sh.p.k për kategorinë e licencës NP-7D të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit nuk mund të konsiderohet e vlefshme në rastin konkret.

Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe Disiplinimin e Punëve të ndërtimit” ndryshuar, në nenin 8, Drejtuesi Teknik”, parashikon: “1.Drejtuesi teknik është solidarisht përgjegjës me zbatuesin e punimeve, për të realizuar punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.

3. Drejtuesi i punimeve është pjesë e stafit të zbatuesit të punimeve i përcaktuar në Licencën e shoqërisë”.

Ndërsa në Kreun IV “Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë” të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar parashikohet:

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

Pika 2 e nenit 84 të LPP-së parashikon se Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë, ndërsa pika 6 e po këtij neni përcakton se, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. Në rastin konkret subjekti tjetër I.D.K. Konstruksion referuar deklaratës së angazhimit për mbështetje në kapacitete rezulton të ketë ofruar vetëm kategorinë e Licencës por nuk rezulton se punët për të cilat kërkohet aftësia profesionale do të kryhen nga vetë ai apo akoma më tej nga stafi i tij. Në gjykimin e KVO nuk ka asnjë kuptim mbështetja në licencës e shoqërisë tjetër kur në fakt të gjitha punët për të cilat kërkohet mbështetja në kapacitete do të kryhen nga vetë ofertuesi i cili nga ana tjetër nuk është i licensuar për ti kryer ato. Referuar përkufizimit “Licencë profesionale” është leja për ushtrimin e aktivitetit në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim me të cilin ka detyrimin të pajiset çdo subjekt juridik/fizik, privat ose publik, që dëshiron të ushtrojë veprimtari në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim dhe plotëson kushtet për t'u pajisur me një të tillë. Pra, Licenca profesionale është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë, i cili nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi si dhe Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente sic janë: - Vlera e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri; - Përvojën

në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë dhe Kapacitetet financiare. Pra, edhe kryerja e puneve të zbatimit të punimeve sëbashku me vlerat financiare të tyre, shërbejnë në klasifikimin e kategorive të punimeve të përfituara nga zbatimit i puneve të ndërtimit. Pra referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, vlera financiare e përfituar nga kryerja e punimeve ndërtimore, ndikon në përfitimin e kategorive dhe klasifikimit të niveleve të licencës. Për rrjedhojë, përvoja në punët e zbatimit në ndërtim, si dhe licenca profesionale, së bashku me drejtuesin teknik të përfshirë në të, janë elemente të lidhura ngushtë me subjektin që do të realizojë zbatimin e punimeve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. LPP në nenin 14 të tij i jep mundësinë operatorit ekonomik në rastet kur nuk i plotëson i vetëm kriteret e kualifikimit të paraqitet në procedurë në formën e një bashkimi operatorësh ekonomikë. KVO në bazë të nenit 82 pika 2 e VKM nr.285 date 19.05.2021 i ndryshuar ku parashikohet se Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme, vendos që ofertuesi të skualifikohet.

II.5. Në datë 24.08.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit nga ku është shpallur fitues operatori ekonomik “Ed Konstruktion” SHPK.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 27.08.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2026/7209, dhe nr. 2667/2026, datë 27.08.2026 e operatorit ekonomik “T & XH” SHPK, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentat si vijon:

1. Vendosja e një kufizimi të paparashikuar në DST. Pika 2.16 e DST-së i shërben identifikimit të detyrave, punëve ose aspekteve kritike që autoriteti kontraktor kërkon të kryhen drejtpërdrejt nga ofertuesi dhe për të cilat nuk lejohet mbështetja. Në këtë rubrikë autoriteti ka shënuar JO dhe nuk ka individualizuar asnjë punë apo aspekt kritik. Për rrjedhojë, nuk ekziston në dokumentet e tenderit asnjë ndalim që kategoria NP-7 D të plotësohet nëpërmjet kapaciteteve të një subjekti tjetër. Zbatimi i një ndalimi të tillë vetëm në fazën e vlerësimit përbën ndryshim ex post të rregullave të procedurës dhe cenon transparencën, sigurinë juridike, trajtimin e barabartë dhe konkurrencën.

2. Zbatimi i gabuar i nenit 84 të LPP-së dhe nenit 90 të VKM-së nr. 285/2021. Këto dispozita i njohin operatorit ekonomik të drejtën të mbështetet në aftësitë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, kur provohet se burimet përkatëse do të jenë realisht në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës. Edhe APP, në Sjelljen në vëmendje nr. 1420 prot., datë 13.02.2025, ka sqaruar se, kur në dokumentet e tenderit nuk është specifikuar një ndalesë për detyra, punë ose

aspekte kritike, oferta duhet të vlerësohet duke marrë në konsideratë mbështetjen në kapacitetet e subjektit tjetër, deklaratën e angazhimit dhe dokumentacionin e tij kualifikues.

3. Ekzistenca e një mbështetjeje reale dhe efektive. Në rastin konkret nuk është paraqitur vetëm një dokument licence. I.D.K.-Konstruksion sh.p.k. ka marrë përsipër me shkrim vënien në dispozicion të kapacitetit profesional, personelit të kualifikuar dhe mjeteve për periudhën e zbatimit të kontratës. Kjo provon disponueshmërinë reale të burimeve dhe garanton se punimet përkatëse do të mbulohen nga kapacitetet e subjektit që zotëron kategorinë profesionale NP-7 E. Prandaj, marrëdhënia nuk përbën transferim apo huazim formal të licencës, por mbështetje në aftësinë profesionale dhe në burimet konkrete të subjektit të licencuar, sipas mekanizmit të parashikuar nga ligji.

4. Përmbushja e nivelit të kërkuar. Kërkesa e DST-së është NP-7 D. T & XH sh.p.k. disponon NP-7 A, ndërsa subjekti mbështetës I.D.K.-Konstruksion sh.p.k. disponon NP-7 E. Niveli E është më i lartë se niveli D dhe e përmbush e tejkalon kërkesën. Për rrjedhojë, fakti që ofertuesi disponon vetë NP-7 A nuk mund të vlerësohet i shkëputur nga kapaciteti NP-7 E, deklarata e angazhimit dhe burimet e subjektit mbështetës të paraqitura në të njëjtën ofertë. KVO-ja kishte detyrimin ta shqyrtonte ofertën në tërësinë e saj dhe sipas kushteve të publikuara në DST.

Për sa më sipër, kërkohet: (i) pranimi i ankimit si i bazuar në ligj dhe në prova; (ii) shfuqizimi i vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së T & XH sh.p.k.; (iii) anulimi i njoftimit të fituesit paraprak, nëse është publikuar; dhe (iv) kthimi i procedurës në fazën e shqyrtimit dhe rivlerësimit të ofertave, duke marrë në konsideratë vlefshmërinë e mbështetjes në kapacitetet e I.D.K.-Konstruksion sh.p.k. dhe përmbushjen e kërkesës NP-7 D nëpërmjet kategorisë NP-7 E të subjektit mbështetës.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i bdryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2667/1 prot., datë 28.08.2026 me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Me datë 31.08.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike nga ana e operatorit ekonomik ankimues “T & XH” është paraqitur kërkesa me objekt “Kërkesë për tërheqjen e ankimit nr. A/2026/7209”, protokolluar me tonën me nr. 2667/2 prot., datë 31.08.2026, nga verifikimi i kërkesës rezulton se është firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë dhe me përmbajtje si mëposhtë vijon:

Shoqëria “T & XH” SHPK, me NUIS L72121504I, në cilësinë e operatorit ekonomik ankimues në procedurën e sipërcituar, ka paraqitur ankimin nr. A/2026/7209 kundër vendimit për skualifikimin e ofertës së saj. Shoqëria nuk është shpallur fituese në procedurën objekt të këtij

ankimi. Vendimi për tërheqjen e ankimit është diktuar nga rrethana objektive që lidhen me ngarkesën kontraktore të shoqërisë. “T & XH” SHPK është shpallur fituese në disa procedura të tjera prokurimi dhe ka marrë përsipër detyrimet kontraktore që burojnë nga punë të tjera publike dhe private. Në funksion të përmbushjes së këtyre detyrimeve, kapaciteti njerëzor i shoqërisë do të angazhohet në zbatimin e kontratave përkatëse. Për rrjedhojë, shoqëria ndodhet në pamundësi objektive për të garantuar disponueshmërinë e stafit të nevojshëm për marrjen përsipër të një angazhimi kontraktor shtesë që mund të rezultojë nga vijimi i procedurës së sipërcituar, pa cënuar përmbushjen brenda afateve dhe me cilësinë e kërkuar të detyrimeve të tjera kontraktore. Në këto kushte, me qëllim administrimin e përgjegjshëm të kapacitetit njerëzor dhe garantimin e përmbushjes së rregullt të detyrimeve kontraktore të marra përsipër, shoqëria ka vendosur të ushtrojë të drejtën e tërheqjes së ankimit dhe të mos vijojë më tej me shqyrtimin e tij. Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, deklarojmë tërheqjen e ankimit nr. A/2026/7209 dhe kërkojmë ndërprerjen e menjëhershme të shqyrtimit të tij, si dhe mbylljen e çështjes përkatëse. Deklarojmë se jemi në dijeni të pasojave juridike të tërheqjes së ankimit, sipas nenit 117 të ligjit të sipërcituar, përfshirë faktin se tërheqja konsiderohet si mospranim i ankesës dhe se tarifa e ankimit nuk kthehet.

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën nr. 2667/2 prot, datë 31.08.2025 me objekt “Kërkesë për tërheqjen e ankimit nr. A/2026/7209”, e operatorit ekonomik ankimues “T & XH” SHPK protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-93228-07-13-2026, me objekt “Ndërtimi i Kolektorit Kryesor të Kanalizimeve dhe Impiantit të Trajtimit të Ujrave Të Ndotura Maliq”, me fond limit 123,593,424.32 (njqind e njezet e tre milion e pesqind e nentedhjetë e tre mijë e katerqind e njezet e kater pike tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar parashikimeve të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet, se “1. Ankimesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës. 2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.” dhe parashikimeve të nenit 105 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar, dhe tarifa e ankesës nuk kthehet., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt-ankimimin e tij, dhe si pasojë mosshqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë vetë ankimuesi shpreh vullnetin e tij të lirë për t’u tërhequr nga ankesa, të cilën ligjvënësi e ka përcaktuar si një mjet ligjor për t’i ardhur në ndihmë operatorëve ekonomikë të cilëve u janë prekur ose mund t’i preken interesat nga vendimet e autoritetit kontraktor, dhe për sa kohë që ankimuesi nuk shfaq më interes për procedurën e prokurimit në bazë të kërkesës së bërë, atëherë ankesa e bërë prej tij e humbet qëllimin e saj si një mjet ligjor nëpërmjet të cilit operatorët ekonomikë mund të realizonin qëllimin e tyre, për t’u shpallur fitues një procedurë prokurimi. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik “T & Xh” SHPK për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 2667/2026 prot, datë 27.08.2026, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për ankesën e operatorit ekonomik “T & XH” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-93228-07-13-

2026, me objekt “Ndërtimi i Kolektorit Kryesor të Kanalizimeve dhe Impiantit të Trajtimit të Ujrave Të Ndotura Maliq”, me fond limit 123,593,424.32 (njqind e njezet e tre milion e pesqind e nentdhjete e tre mije e katerqind e njezet e kater pike tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.07.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SH.A.

2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “T & XH” SHPK.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu

